



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi
Mbledhja nr. 17-2008
Prishtinë, 08 korrik 2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Riza Smaka, Bajram Kosumi, Ramadan Gashi, Kolë Berisha, Džezair Murati, Adem Hajdaraj.

Munguan: Branisllav Grbiq, Lutfi Haziri dhe Selvije Halimi.

Nga stafi mbështetës i Komisionit në mbledhje ishin të pranishëm: Idriz Tahiri dhe Manush Krasniqi.

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Zeneli - nga KDI, Reshit Gashi-NDI, Hysni Ismajli-praktikant departamenti ligjor K.K, Fatlum Demiri- praktikant nga GP- AAK.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

RENDI I DITES

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e 10 qershorit 2008;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për noterinë dhe i amendamenteve të propozuar;
4. Të ndryshme;

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës;
Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 10 qershorit 2008

Kryetari – I pyeti anëtarët e Komisionit se a kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për noterin dhe i amendamenteve te propozuara;

Kryetari –lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për noterin tha se në mbledhjen e kaluar ne kemi miratua disa amendamente por nëse jeni të pajtimit do ti shqyrtonim prapë se bashku me amendamentet e paraqitura dhe dy shkresa të ardhura nga USAIDI me vërejtjet dhe propozimet që me siguri keni pasur mundësi t'i shikoni. Ai propozoi shqyrtimin e amendamenteve me radhë e pastaj shqyrtimin dhe vërejtjet e USAID-it.

U shqyrtuan këto amendamente që kishin të bënin me ndryshimin dhe plotësimin e neneve të caktuara: Amendamenti 1, që në tërë tekstin e Projektligjit fjala „bord” të zëvendësohet me fjalën „komision” dhe fjala „dhomë” të zëvendësohet me fjalën „odë”. Amendamenti 2 ka të bëjë me riformulimin e nenit 1, amendamenti 3 amendamenton nenin 2, amendamentohet neni 3 paragrafi 1 dhe paragrafi 4. Në titullin e kapitullit II dhe të nenit 4 shprehja „përshtatshmëri” zëvendësohet me shprehjen „kushtet”. Amendamentohet edhe neni 4 paragrafi 1, pikat: a, b, c, ç, d, dh, e. U amendamentuan neni 4 në të cilin pas paragrafit 1 shtohet një paragraf i ri paragrafi 2, neni 4 paragrafi 3, neni 5 paragrafët 1 dhe 6, neni 7 paragrafët 1 dhe 2, neni 7 paragrafi 4, Po ashtu u amendamentua edhe neni 9, paragrafët 1 dhe paragrafi 3 në pikën c) dhe paragrafi 5. U amendamentuan titulli i nenit 10 dhe paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 i këtij neni. Neni 11 paragrafi 1. Amendamentet e tjera kishin të bënin me nenin 13 paragrafi 5, me nenin 17 paragrafi 1, nenin 16 paragrafi 6 dhe me nenin 17 paragrafi 5. Titulli i nenit 20 „Paaftësitë” u zëvendësua me titullin „Konflikti i interesave” dhe u riformulua paragrafi 4 i nenit 22. U amendamentuan edhe neni 23 paragrafi 3 dhe neni 25, që në titull hiqet shprehja „vënia në status joaktiv”. Po ashtu në këtë nen pika a). “nga kapaciteti i tij apo i saj ligjor” të zëvendësohet me shprehjen “nga aftësia për të vepruar”. U amendamentuan neni 26 paragrafi 1, neni 29, që pas pikës e), shtohet pika ë) me këtë përmbajtje „përpilimi dhe vërtetimi i kontratave”.dhe amendamenti i fundit ka te beje me neni 63.2 ku shtohet fjalia me përmbajtjen „Anëtarësimi në Odën e Noterëve është i detyrueshëm”

Ne shqyrtimin e hollësishëm të këtij projektligji kontribuuan të gjithë anëtarët e komisionit me një debat të frytshëm ku pati disa ndërhyrje në amendamente në aspektin gjuhësorë dhe teknik dhe me mendimet e tyre u bënë me të begatshme dhe më të qarta.

P ë r f u n d i m

- Komisioni miratoj unanimitet amendamentet e shqyrtuara në Projektligjin për Noterin.
- Komisioni vendosi që ky projektligj të procedohet me tutje dhe obligoj stafin mbështetës të komisionit që të përgatit raportin dhe së bashku me amendamentet të ja dërgoj për shqyrtim komisionit për buxhet e financa dhe komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim me qëllim të procedimit të mëtutjeshëm për shqyrtim nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Të ndryshme;

- Në pikën e katërt të rendit të ditës të ndryshme Kryetari i komisionit propozoi që të shqyrtohej raporti nga komisioni për Buxhet e Financa dhe nga komisioni për Kthim e Komunitete për Projektligjin për Ndërmjetësimin, dhe tha se tani e kemi bërë si praktikë që për çdo projektligj ti shqyrtonim këto raporte edhe një herë në komision për ti evituar gabimet dhe paqartësitë e mundshme.

-Kryetari i komisionit njoftoj edhe për një letër që do ti dërgohet Ministrisë së Drejtësisë për një vizitë që do ta bëjë komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi në Entin Ndëshkimor në Dubravë dhe në ndonjërin nga gjykatat komunale në Prishtinë për tu njoftuar se si po zbatohet ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, pasi që Ministria e Drejtësisë i ka ne mbikëqyrje gjykatat, dhe tha që kjo vizitë mundësisht të jetë e realizuar në atë kohë ku mund të jen prezentë të gjithë anëtarët e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Procesverbali u hartua nga stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i komisionit

Bahri Hyseni